



---

**VENDIM**

**Nr. 4 Datë 20.01.2010**

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR  
LICENSIMIN E SHOQËRISË “ALPIQ ENERGY ALBANIA”  
SH.P.K NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TE KUALIFIKUAR  
TE ENERGJISE ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9, dhe nenit 45 pikat “3” dhe “4”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “f”, nenve 5, 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, nenit 18, pikat 1, germa “a”, dhe 3, të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerve, Nr.21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 20.01.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k për licensim në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

**Dhe Konstatoi se :**

Aplikimi i shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- o Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni finaciar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



---

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për liçensë të shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s**  
**Bujar Nepravishta**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



---

Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

***VENDIMIN***  
***Nr. 4 Datë 20 .01.2010***

**PËR**  
**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR**  
**LICENSIMIN E SHOQËRISË “ALPIQ ENERGY ALBANIA”**  
**SH.P.K NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TE KUALIFIKUAR**  
**TE ENERGJISE ELEKTRIKE**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
<b>Bujar Nepravishta</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Ardian Haçi</b>	_____	_____

**Abaz Aliko**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Shkelqim Bozgo**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_